



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË

Nr. 4347 Prot

Tiranë, 01.09.2023

**NJOFTIM**

**PËR SHPALLJE PËR LEVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË E ULËT DREJTUESE**

Bazuar në ligjin nr. 98/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, vendimin nr. 622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil”, vendimin nr.643, datë 23.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësiive të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë”, si dhe vendimin nr.1, datë 21.01.2021 të Këshillit të Gjykatës, Gjykata e Lartë, **shpall procedurën e lëvizjes paralele, ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor** për pozicionin si më poshtë:

- **1 ( një) pozicion** - përgjegjës/e sektori, në Sektorin e Sigurisë, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë, kategoria e ulët drejtuese, III-1

*Pozicioni më sipër, u afrohen fillimisht nëpunësve civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori për procedurën lëvizjes paralele. Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.*

**Për të tre procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor) aplikohet në të njëjtën kohë.**

Afati i dorëzimit të dokumentacionit për

**Lëvizje paralele**

**14.09.2023**

Afati i dorëzimit të dokumentacionit për

**Ngritje në detyrë**

**21.09.2023**

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:**

1. Përgjigjet për ruajtjen e qetësisë dhe funksionimin e rregullt të çdo shërbimi në institucion.
2. Mbikëqyr dhe disiplinon hyrjen dhe daljen në ambientet e Gjykatës së Lartë, në përputhje me rregullat e parashikuara në Rregulloren e Brendshme të Gjykatës së Lartë.
3. Organizon shërbimin e rojës për sigurinë në ndërtesën e Gjykatës së Lartë.
4. Siguron rregullin dhe rendin gjatë seancave gjyqësore duke qenë në dispozicion të kryesuesit të Kolegjit.
5. Së bashku me stafin e sektorit është në gatishmëri për të mbrojtur, gjatë kryerjes së detyrës, çdo punonjës të Gjykatës së Lartë nga qëndrime të padrejta dhe jo etike të qytetarëve, të cilët në të tilla raste, shoqërohen jashtë ambienteve të gjykatës, duke përdorur edhe forcën fizike nëse është e nevojshme.
6. Mbajnë rregull dhe qetësi në hollin e shërbimit për publikun, si dhe ndihmojnë në orientimin e publikut për funksionet që ka secila sekretari.
7. Mban evidencë të rregullt për prezencën në punë dhe lëvizjet jashtë gjykatës, ndaj të gjithë punonjësve, duke raportuar me shkrim çdo ditë tek Kancelari.
8. Instrukton punonjësit e sektorit për të shoqëruar vizitorët e ndryshëm në ambientet e gjykatës sipas rregullave të përcaktuara për sigurinë, duke plotësuar evidencën përkatëse për takimin dhe kohën e kryer.
9. Merr masat e duhura për krijimin e kushteve normale për studimin e dosjeve nga avokatët, duke i kërkuar vartësve për të mbajtur evidencë sipas rregullores së institucionit të miratuar.
10. Të jetë i vëmendshëm dhe i angazhuar gjatë gjithë kohës, në rastet e pritjes së delegacioneve të huaja dhe të titullarëve të institucioneve të rëndësishme të shtetit.
11. Ndjek detyrat e vëna nga Kancelari gjatë periudhës së pushimeve verore kur ka punime në ambientet e gjykatës.
12. Përgjigjet tek Kancelari për kryerjen e detyrave ditore dhe mban lidhje të vazhdueshme me të, për diskutimin dhe vendimmarrjen në zgjidhjen e problemeve.

**1. LËVIZJA PARALELE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit gjyqësor.

**1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori.
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- Të zotërojnë një diplomë “Master Shkencor “ose “Master Profesional “ të barasvlershëm me të (2 vite akademike) në studimet e larta universitare, në fushën e sigurisë dhe të rendit, si dhe shkencat juridike. Edhe diploma “Bachelor” duhet të jetë në një prej këtyre fushave.
- Të ketë të paktën 5 (pesë) vite pune në fushën e sigurisë dhe të rendit në institucionet publike të rëndësisë së veçantë.
- Të ketë njohuri mjaft të mira në fushën e sigurisë dhe të paraqesë periodikisht plane masash për rritjen e sigurisë në institucion.
- Të ketë njohuri në gjuhën angleze ose të një gjuhe tjetër të BE-së.
- Të ketë aftësi shumë të mira organizative, komunikimi, si dhe për të punuar në grup.
- Të ketë njohuri praktike në përdorimin e programeve të kompjuterit.
- Të jetë i aftë të raportojë në kohë për detyrat e ngarkuara.
- Të plotësojë të gjitha kushtet e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, sipas nenit 57, të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

**1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët duhet të dorëzojnë ,pranë protokollit të Gjykatës së Lartë brenda datës **14.09.2023**, dokumentet si më poshtë vijon:

- a- Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:  
[http://dap.gov.al/vende -vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta](http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta).
- b- Kërkesë motivimi për aplikim për vendin e lirë të punës.
- c- Fotokopje e diplomës dhe të listës së notave (përfshirë edhe diplomën Bachelor).
- d- Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë).
- e- Fotokopje e letërnjoftimit (ID).
- f- Vërtetimin e gjendjes shëndetësore.
- g- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.
- h- Vlerësimet e fundit nga eprori direkt.
- i- Vërtetimin nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- k- Aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit si drejtues i nivelit të ulët.

***Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikimin e kandidatit.***

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në zyrën e Protokollit, të Gjykatës së Lartë, brenda datës **14.09.2023**.

### **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **19. 09. 2023**, Kancelari do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, si dhe në tendën e afishimeve të njoftimeve për publikun, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

### **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- b- Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.
- c- Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- d- Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- e- Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.
- f- Njohjes së legjislacionit në fushën e sigurisë dhe ruajtjes së rendit.

### **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës.
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme.
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 85, datë 11.03.2021 të KLGJ-së “ *Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurrimit të hapur*”.

### **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë , në rubrikën “Marrëdhëniet me publikun “.

## **2. NGRITJE NË DETYRË**

*Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ka ende pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë, në rubrikën e njoftimeve të Gjykatës së Lartë, duke filluar nga data **22.09.2023**.*

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët e institucioneve, të cilat janë pjesë e shërbimit gjyqësor dhe që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas neneve 9, 57, etj, të ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

***Kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta që duhet të plotësojnë kandidati në procedurën e “Ngritjes në detyrë” janë të njëjta me ato të” Lëvizjes paralele”.***

### **2.1 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet, deri më datë **21.09.2023**, si më poshtë vijon:

- a- Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:  
[http://dap.gov.al/vende -vakante/udhëzime-dokumenta/219-udhëzime-dokumenta](http://dap.gov.al/vende-vakante/udhëzime-dokumenta/219-udhëzime-dokumenta).
- b- Letër motivimi për aplikim për vendin vakant.
- c- Fotokopje e diplomës dhe listës së notave (përfshirë edhe diplomën Bachelor).
- d- Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë).
- e- Fotokopje e letërnjoftimit (ID).
- f- Vërtetimin e gjendjes shëndetësore.
- g- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.
- h- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- j- Vërtetimin nga institucioni i fundit ku ka punuar, që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Aktin e deklaramit të statusit të nëpunësit civil në nivelin ekzekutiv.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve të sipërpërmendura për procedurën e ngritjes në detyrë duhet të bëhet brenda datës **21.09.2023**.

### **2.2 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **25.09.2023**, Kancelari , do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, në rubrikën e njoftimeve për publikun, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe

kërkesat e veçanta me procedurën e ngritjes në detyrë, si dhe **datën, vendin dhe orën** e saktë ku do të zhvillohet testimi i kandidatit.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e pranimit të ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail ose me celular).

### **Vlerësimi i kandidatëve përfshin**

**a.** 70 (shtatëdhjetë) pikë për vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar, që konsiston në vlerësimin e rezultateve të punës, përvojës profesionale dhe trajnimeve të lidhura me fushën përkatëse,

**b.** 30 (tridhjetë) pikë për intervistën e strukturuar me gojë.

Pikët për dokumentet e paraqitura dhe për intervistën me gojë, mbliidhen. Kandidati që merr më pak se **70 pikë** nuk konsiderohet i suksesshëm. Këshilli i Gjykatës zgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikë maksimale, për t'u emëruar në vendin e lirë.

### **2.3 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË TESTOHET KANDIDATI**

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- a- Njohuritë dhe aftësitë në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës.
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme.
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

### **2.4 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Kancelari i Gjykatës së Lartë, do të njoftojë për fituesin e shpallur nga Këshilli I Gjykatës në faqen zyrtare, në rubrikën e njoftimit për publikun, brenda **datës 06.10.2023**. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

## **3. PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR**

*Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë rezulton se pozicioni i shpallur është ende vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrim nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor. Këtë informacion do ta merrni në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë, në rubrikën “Marrëdhënie me publikun – vende vakante, duke filluar nga **data 26.09.2023**.*

Kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta që duhet të plotësojnë kandidati në procedurën e “Pranimi në shërbimin civil gjyqësor” janë të njëjta me procedurën e “Lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë”.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët e institucioneve, të cilët nuk janë pjesë e shërbimit civil gjyqësor dhe që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimi në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë drejtuese, do të marrin informacion në faqen e Gjykatës KLGJ dhe të KLGJ-së , për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimi në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë drejtuese:

- **Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.**
- **Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.**

## **II.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatët do të vlerësohen:

- a. 60 (gjashtëdhjetë) pikë** për vlerësimin me shkrim.
- b. 40 (dyzet) pikë** për vlerësimin nga Këshilli.

### **KËSHILLI I GJYKATËS**

#### **GJYKATA E LARTË**

Rr. Ibrahim Rugova, Nr.10, 1001 Tiranë